



Përgjigje

Nr.	Përgjigja	Nr.	Përgjigja
1	B	10	E gabuar
2	B	11	E vërtetë
3	C	12	E gabuar
4	B	13	E gabuar
5	D	14	E gabuar
6	B	15	E vërtetë
7	C	16	E vërtetë
8	B	17	E gabuar
9	C	18	E gabuar
		19	E vërtetë
20	<p>Ndarja e detyrave është e rëndësishme sepse nënkupton që asnjë individ nuk duhet të ketë kontroll të plotë mbi të gjitha fazat e një procesi të rëndësishëm financiar ose operativ, për të shmangur mundësinë e keqpërdorimit ose kryerjen e gabimeve. Nëpërmjet ndarjes së detyrave, kërkohet përfshirja e dy ose më shumë personave në kryerjen e një shkelje apo mashtrimi, e cila e bën më të vështirë realizimin e mashtrimit.</p>		
21	<p>Metoda e kontabilitetit të angazhimeve të konstatuara (<i>accrual basis</i>) regjistron të ardhurat dhe shpenzimet kur ndodhin, edhe nëse pagesat nuk janë bërë, duke dhënë një pamje më të saktë të gjendjes financiare. Ndërsa metoda e kontabilitetit të pagesave dhe arkëtimit (<i>cash basis</i>) regjistron transaksionet vetëm kur ndodhin pagesat ose arkëtimet, duke reflektuar fluksin e parave aktualisht të disponueshme, por jo gjendjen e vërtetë financiare. Kontabiliteti sipas angazhimeve të konstatuara është më kompleks dhe më i saktë, ndërsa ai me bazë të arkëtimit është më i thjeshtë, por më pak i detajuar.</p>		
22	<p>Kontrollet kompensuese janë masa shtesë që ndihmojnë në zbutjen e rreziqeve kur ndarja e detyrave nuk është e mundur, si në bizneset e vogla. Janë të rëndësishme sepse ndihmojnë në parandalimin e mashtrimeve apo gabimeve duke siguruar mbikëqyrje dhe rishikimi, edhe kur një person ka përgjegjësi të shumta në proceset financiare.</p> <p>Disa shembuj të kontrolleve kompensuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Mbikëqyrje e pavarur: Pronari ose një menaxher tjetër rishikon aprovimin e transaksioneve financiare të kryera nga një punonjës. – Rishikimi i pasqyrave financiare: Pronari ose një auditor i jashtëm kontrollon rregullisht pasqyrat financiare për të identifikuar gabime ose parregullsi. – Auditim i brendshëm periodik: Kryerja e auditimeve të rregullta për të siguruar saktësinë e të dhënave financiare dhe për të zbuluar çfarëdo parregullsie. – Verifikim i pagesave: Një person tjetër kontrollon saktësinë e pagesave të kryera, duke siguruar që të mos ketë abuzime. – Kufizim në autorizimin e pagesave: Vetëm pronari ose një menaxher autorizon pagesat mbi një shumë të caktuar, duke ndihmuar në mbikëqyrjen e shpenzimeve. 		
23	<p>Tre shembuj të kontrolleve të brendshme që ndihmojnë në zbutjen e rreziqeve në kontabilitet janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Ndarja e detyrave: Shpërndarja e përgjegjësisive midis individëve të ndryshëm për të parandaluar që një person të ketë kontroll të plotë mbi një proces financiar (p.sh., një person regjistron faturat, ndërsa tjetri bën pagesat). 		



	<ul style="list-style-type: none">– Rishikimi dhe miratimi i transaksioneve: Çdo transaksion i rëndësishëm financiar (si pagesat ose shitjet) rishikohet dhe miratohet nga një person tjetër për të siguruar saktësinë dhe legjitimitetin e tij.– Rakordimi periodik i llogarive: Rregullisht krahasohen shifrat e regjistruara me dokumentet mbështetëse (si bankat dhe faturat) për të identifikuar dhe korrigjuar mospërputhjet ose gabimet në llogari.
24	Nga listëpagesa mund të merren shumë informacione, por nga më të rëndësishmet që lidhen me kontratën janë: pagat bruto, orët/ditët e punës, bonuset, kompensimet dhe ndalesat për të verifikuar nëse ato përputhen me kushtet e përcaktuara në kontratat e punës, duke siguruar që punonjësit po paguhen në përputhje me marrëveshjet e tyre.
25	Konfirmimet e palëve të treta janë të rëndësishme në rastet ligjore që përfshijnë mosmarrëveshje financiare sepse ato sigurojnë prova të pavarura dhe të besueshme për të vërtetuar saktësinë e transaksioneve ose bilanceve financiare. Ato ndihmojnë në konfirmimin e fakteve nga burime të jashtme, duke zvogëluar mundësinë e manipulimit të informacionit dhe duke forcuar besueshmërinë e provave financiare në gjykatë.
26	<p>Kur një magjistrat shqyrton një faturë si pjesë e një çështjeje ligjore, ai/ajo duhet të kërkojë:</p> <ul style="list-style-type: none">– Saktësia e informacionit: Verifikimi i të dhënave të faturës, përfshirë emrin e palës që e ka lëshuar, emrin e klientit, datën e lëshimit, dhe përshkrimin e mallrave ose shërbimeve të ofruara;– Numrin e faturës dhe datën përkatëse;– Përputhshmërinë me kontratën ose porosinë e bërë, mënyrën dhe afatet e pagesës;– Element shtese si të drejtat për kthimin e mallit apo penalitetet në rast vonese në likudim, etj. <p>Këto elemente ndihmojnë në vlerësimin e vlefshmërisë së faturës si provë në çështjen ligjore.</p>
27	<p>Llogaritë bankare mund të shërbejnë si provë në një mosmarrëveshje ligjore në disa mënyra:</p> <ul style="list-style-type: none">– Të dhënat e llogarive bankare tregojnë të gjitha transaksionet financiare, duke përfshirë pagesat dhe arkëtimet, që mund të vërtetojnë ose hedhin poshtë pretendimet e palëve në një mosmarrëveshje.– Krahasimi i informacionit në llogaritë bankare me dokumentet e tjera, si faturat dhe marrëveshjet, ndihmon në verifikimin e saktësisë së transaksioneve dhe mund të zbulojë ndonjë mospërputhshmëri.– Një llogari bankare mund të tregojë prova të pagesave të kryera për shërbime ose mallra, si dhe çdo vonesë në pagesa, e cila mund të jetë me vlerë për shqyrtimin e mosmarrëveshjes.– Historiku i llogarive bankare ndihmon në analizimin e flukseve të parasë, duke zbuluar ndonjë ndryshim të papritur ose të dyshimtë që mund të jetë i rëndësishëm për rastin.– Të dhënat e llogarive bankare mund të ndihmojnë në identifikimin e palëve të angazhuara në transaksione dhe të konfirmojnë lidhjet e tyre financiare. <p>Këto aspekte ndihmojnë magjistratët për të formuar një pamje më të plotë dhe të qartë të situatës financiare që lidhet me mosmarrëveshjen ligjore.</p>